



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:009263

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874596

KPPP.nr.70/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Horizonti Impex” SH.P.K., me NUI: 811391101, me seli në Suharekë, rruga “Skënderbeu”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Asman Hoxha, avokat nga Prizreni, kundër debitorit “Hidroterm” SH.P.K., me NUI: 810634867, me seli në Suharekë, rruga “Brigada 123”, përfaqësuar sipas autorizimit nga Nadire Hoxha, avokate nga Suhareka, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.378/2023 të datës 27.11.2023, të Përmbartuesit Privat Mehdi S. Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Hidroterm” SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.378/2023 i datës 27.11.2023, i Përmbartuesit Privat Mehdi S. Reshani, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.
- II. DETYROHET kreditori që në emër të përpilimit të prapësimit, t’ia paguaj debitorit shumën prej 208.00 € (dy qind e tetë euro), në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr.378/2023, të datës 27.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturën Nr. A/81-e të datës 30.11.2020 dhe Faturën Nr. A/94-e të datës 19.12.2020, me të cilin është urdhëruar debitori që t’ia paguaj kreditorit shumën 20,430.14 €, me kamatë ligjore 8% nga data e afatit për pagesë e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë, me bartjen e

mjeteve financiare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e veçantë bankare të kreditorit, me sekuestrimin, regjistrimin, shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në përmbushjen e borxhit ndaj kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se të gjitha pagesat sipas faturave të cilat janë objekt i kësaj çështje përmbarimore janë ekzekutuar, debitori nuk ka asnjë obligim monetar ndaj kreditorit sipas faturave për të cilat është lejuar përmbarimi. Tutje ka shtuar se për Faturën Nr. A/81-e në shumë prej 50,753.94 €, debitori ka realizuar pagesat me datë 18.12.2020 në shumën prej 20,000.00, me datë 21.12.2020 në shumën prej 20,000.00 € si dhe sipas urdhër pagesës kombëtare për përmbledhjen e faturave në të cilën është përfshirë edhe pjesa e mbetur e kësaj fature përkatësisht shumën prej 10,753.94 €, ndërsa Fatura Nr. A/94 – e me datë 19.12.2020 është realizuar pagesa në tërësi në shumën prej 9,676.20 €. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta refuzoj si të pabazuar, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të prapësimin në shumën prej 208.00 €.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësimi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi është në tërësi i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbaruesit Privat Mehdi S. Reshani, P.nr.378/2023 të datës 27.11.2023, në shumën prej 60,430.14 €, është përmbushur në tërësi.

Gjykata duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga dëshmitë e pagesave me numër Ref. 534512154 të datës 18.12.2020, Ref. 535765320 të datës 31.12.2020 dhe dëshmia me numër Ref. 533891983 të datës 10.12.2020, vërtetoi faktin se debitori e ka përmbushur detyrimin në shumën prej 50,753.94 €, sipas Faturës Nr. A/81-e të datës 30.11.2020, ndërsa nga dëshmia e pagesës Ref. 540788860 të datës 24.02.2021, vërtetoi faktin se debitori ka përmbushur detyrimin në shumën prej 9,676.20 €, sipas Faturës Nr. A/94-e të datës

19.12.2020, për të cilat është iniciuar propozimi për përmbarim dhe është lëshuar urdhri përmbarimor, andaj vlerësoi se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se “*dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik*”, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarimor, e kanë humbur efektin juridik, sepse të njëjtat janë përmbushur në tërësi nga ana e debitorit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i’ a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e prapësimit dhe atë në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në faktin se debitori e ka përmbushur detyrimin e tij ndaj kreditorit, gjykata vlerësoi se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 66 par.4 të LPP-së me të cilin përcaktohet se: “*Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore*”, përfundoi në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata në kuptim të nenit 66, nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par.1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.70/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.